



## TAKIMI/ Roli i Diasporës në procesin e integrimit, prezantohen ekspertët e përzgjedhur



Në Tiranë u prezantuan nëpërmjet një takimi online ekspertët e përzgjedhur që jetojnë në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë që do të kenë rol në integrimin e vendit në BE përmes programit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Ekonomik dhe Social të Shqipërisë”.

Në fjalën e tij Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko tha se ekspertët e përzgjedhur përbëjnë një vlerë të shtuar për administratën shqiptare në një proces që nga pikëpamja profesionale nuk do të jetë i lehtë.

Diaspora shqiptare po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për zhvillimin e Shqipërisë. Ekonomia e vendit ka përfituar ndjeshëm nga hyrjet e remitancave, megjithatë ekziston nevoja për të mbështetur mënyra të reja për promovimin e angazhimit të Diasporës për të ruajtur dhe forcuar lidhjen e tyre me Shqipërinë dhe për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe sociale të vendit.



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## "GREENBACK 2"/ Diskutohen remitancat me Diasporën në Itali

Projekti “Greenback 2” i Bankës Botërore dhe organizata “Germin” organizuan takimin e radhës online, këtë herë me përfaqësues të Diasporës Shqiptare në Itali, ku u diskutua mbi rëndësinë e remitancave të Diasporës dhe rrugëve për t'i përdorur ato dhe kursimet e përfaqësuesve të Diasporës në mënyrën më efektive për ta dhe ekonominë e Shqipërisë.

Eksperti i Çështjeve Ekonomike pranë Ministrisë së Shtetit për Diasporën, z. Fatos Çoçoli, prezantoi qasjen e strukturave të Diasporës të ngritura nga Qeveria shqiptare, sidomos të “Fondit të Zhvillimit të Diasporës” dhe “Dhomës së Biznesit të Diasporës”, në lidhje me dërgesat e parave dhe shërbimet financiare, të përqëndruara në identifikimin e praktikave më të mira për të kanalizuar remitancat përmes rrugëve formale, zgjerimin e mundësive për të dërguar dhe marrë remitanca me kosto më të ulët, si dhe integrimin më mirë të dërgesave në mundësi për investime për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare.



## Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## UKRAINË/ Brenda 2021 një Qendër e Kulturës Shqiptare në Universitetin e Izmailit



Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko realizoi sot një takim me Konsullin e Nderit të Republikës së Shqipërisë në Ukrainë, Shahin Omarov.

Në këtë takim fokusi i bisedës ishin marrëdhëniet Shqipëri-Ukrainë, si dhe vëmendja ndaj komunitetit shqiptar në Ukrainë. Gjatë takimit u diskutuan disa pika kryesore si hapja e Qendrës së Kulturës Shqiptare në Universitetin e Izmailit brenda vitit 2021.

Gjithashtu palët folën edhe për organizimin e shkëmbimit midis nxënësve mes Shqipërisë dhe Ukrainës.

Ministri Majko u shpreh se do të mundësojnë dërgimin e të gjitha materialeve për hapjen e qendrës në Universitetin e Izmail. Krijimi i lidhjeve midis kryetarëve të bashkive në Ukrainë dhe atyre në Shqipëri ishte një tjetër pikë e rëndësishme e diskutimeve, që do të vlejë si një ura lidhëse mes dy vendeve.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## KOLANA 'THESAURUS'/ Botohen katër librat e parë të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve të Arbëreshëve

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët në një vjetorin e fillimit të funksionimit të saj sjell kolanën e librave “Thesaurus” duke përmbushur kështu një nga objektivat madhorë të saj.

Kolana hapet me librin “Vepra historiko – filologjike dhe publicistike të De Radës”, e kuruar nga Profesor Jup Kastrioti, 905 faqe. Libri i dytë është Monografia “Santorii, poet dhe dramaturg”, me autore studiuesen Klara Kodra. Libri i tretë është: Një rrugëtim në ngulimet arbëreshe, me 452 faqe, një punim divulgativ-deskriptiv, i realizuar nga Anton Bellusci & Ornella Radoviska. Në botimet e para të QSPA përfshihet edhe monografia e njërës prej studiuesve të qendrës, Dr. Silvana Nini, etnografe, e cila sjell studimin “Një rrugëtim etnografik mbi veshjet e Arbëreshëve të Italisë së Jugut.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## Dhuro Libra



Nisma “Dhuro libra” do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)